

# Kodi i Sjelljes





## Përmbajtja

<b>1</b>	Kodi i Sjelljes	4
<b>2</b>	Të drejtat e njeriut – Ndalimet kundër punës së fëmijëve, punësimit të detyruar – Diskriminimi	5
<b>3</b>	Ligjet e kartelit dhe konkurrencës	5
<b>4</b>	Tregtia ndërkombëtare – Mbështetja e luftës kundër terrorizmit	6
<b>5</b>	Siguria, Shëndeti, Mjedisi dhe Cilësia (SHEQ)	6
<b>6</b>	IT/Siguria e të Dhënave – Mbrojtja e të dhënave – Prona e shoqërisë	7
<b>7</b>	Mbrojtja tregtare dhe e drejta e autorit	8
<b>8</b>	Marrëdhëniet me palët e treta – Rregullore kundër korrupsionit – Tregëtim nga persona të brendshëm	8
<b>9</b>	Konfliktet ndërmjet shoqërisë dhe interesave private	9
<b>10</b>	Të dhëna – Dokumentacioni – Informacion i shoqërisë	10
<b>11</b>	Shkeljet e Pajtueshmërisë	10

### »Të nderuar punonjës,

Kodi ynë i Sjelljes krijon një bazë të qëndrueshme nga e cila ne zbatojmë norma etike si integriteti, ndershmëria dhe ligjshmëria në punën tonë të përditshme. Kështu, ai plotëson dhe mbështet deklaratën tonë të misionit, e cila përbëhet nga vizioni ynë, misioni i grupit tonë të korporatës dhe vlerat me të cilat jetojmë.

Kjo e bën Kodin e Sjelljes një pjesë integrale të kulturës sonë dhe të mënyrës se si ne punojmë me njëri-tjetrin dhe me klientët dhe partnerët tanë.

Vetëm duke ndërtuar mbi këto themele, nëpërmjet bashkëpunimit të ndershëm dhe të hapur në të gjitha nivelet, mund të ruajmë reputacionin e mirë të biznesit tone familjar dhe në këtë mënyrë të zgjerojmë më tej suksesin tonë ekonomik.«



### **Bernd Eulitz**

Drejtues i Lartë Ekzekutiv (CEO) i Messer SE & Co. KGaA



## 1 Kodi i Sjelljes

*Në Messer, përqipemi të veprojmë gjithmonë me një shkallë të lartë integriteti dhe besueshmërie në çdo gjë që bëjmë. Që nga fillimi i shoqërisë sonë, Messer ka vlerësuar sjelljen e përgjegjshme ndaj njerëzve dhe mjedisit, dhe respektimin e ligjit, si gurë themeli të mënyrës se si ne bejmë biznes.*

Ne i kushtojmë vlerë dhe rëndësi të lartë besimit të dhënë nga partnerët e biznesit, klientët, autoritetet dhe publiku, se të gjithë punonjësit brenda grupit tonë të shoqërive do të veprojnë me përgjegjësi dhe ligjshmëri, sepse është ky besim që përcakton reputacionin tonë dhe për rrjedhojë, suksesi i shoqërisë sonë.

Kodi i Sjelljes Messer zbatohet në të gjithë Messer<sup>1</sup>. Ai përcakton një kod sjelljeje të standardizuar, globalisht të detyrueshëm<sup>2</sup> për të gjithë punonjësit e Messer-it, bazuar në dhjetë parimet e Kompaktit Global të Kombeve të Bashkuara<sup>3</sup>, i cili fokusohet në të drejtat e njeriut, standardet e punës, mbrojtjen e mjedisit dhe antikorrupsionin.

Kodi i Sjelljes është një komponent thelbësor i Sistemit të Messer për Menaxhimin e Përputhshmërisë, i cili gjithashtu përfshin udhëzime shtesë, mbështetëse të pajtueshmërisë për departamentet individuale në shoqëritë tona.

Nëse standardet e përcaktuara në Kodin tonë të Sjelljes janë të ndryshme nga ato që kërkohen sipas ligjit të zbatueshëm ndërkombëtar ose vendor, do të mbizotëroj ai që është më i rreptë. Kjo do të thotë se edhe në rastet kur ligji ndërkombëtar ose vendor i zbatueshëm është më pak i rreptë, punonjësit duhet t'i përmbahen Kodit të Sjelljes në masën që lejohet ligjërisht.

*Me përkushtimin tonë të qartë ndaj demokracisë, tolerancës dhe mundësive të barabarta, ne jemi plotësisht të përkushtuar ndaj përgjegjësisë sonë globale përtej të gjithë kufijve.*

## 2 Të drejtat e njeriut - Ndalimi i punës së fëmijëve, punësimit të detyruar - Diskriminimi

*Messer respekton të drejtat e të njeriut të njohura në nivel ndërkombëtar dhe parimet të përgjithshme etike kundër punës së fëmijëve dhe punësimit të detyruar.*

Messer i sheh dallimet në punonjësit e saj si një nga pikat e forta të shoqërisë. Këto dallime në aspektin e prejardhjes, kulturës, gjuhës dhe mënyrës së të menduarit na japin një avantazh konkurrues, sepse gatishmëria dhe hapja ndaj gjërave të reja kontribuon në ide dhe inovacione të reja. Messer beson se çdo punonjës ka të drejtë për trajtim të drejtë, mirësjellje dhe respekt.

Prandaj, presim që çdo punonjës të trajtojë kolegët e tij dhe palët e treta në mënyrë të drejtë, me respekt, mirësi dhe profesionalizëm. Asnjë formë diskriminimi – qoftë në bazë të gjinisë, përkatësisë etnike, ngjyrës së lëkurës, moshës, fesë, prejardhjes apo gjendjes fizike – nuk do të tolerohet në Messer.

*Ne do të ndërmarrim hapa vendimtarë kundër çdo punonjësi që përfshihet në diskriminim, trajtim preferencial, ngacmim, përjashtim ose çdo shkelje tjetër kundër dinjitetit dhe respektit të punonjësve në vendin e punës.*

## 3 Ligjet e kartelit dhe konkurrencës

Kartelet dhe ligjet e konkurrencës (të njohura edhe si antitrust) promovojnë dhe mbrojnë konkurrencën e lirë, të ndershme dhe të vërtetë për të gjithë pjesëmarrësit e tregut dhe sigurojnë që të shërbehen interesat më të mira të konsumatorit.

Ato ndalojnë të gjitha masat, marrëveshjet dhe veprimet që mund të çojnë në kufizime të padrejta në tregti ose konkurrencë. Messer mbështet konkurrencën e fuqishme, të ligjshme dhe etike dhe do të jetë në përputhje me të gjitha ligjet e kartelit dhe konkurrencës kudo që bën biznes.

Në veçanti, kjo vlen për vendosjen e çmimeve në mënyrë jo të drejtë, marrëveshjet për të bojkotuar disa shtete, furnitorë ose klientë, shpërndarjen e klientëve ose tregut, dhe marrëveshjet për të kufizuar shpërndarjen ose prodhimin, të cilat të gjitha përbëjnë një shkelje të qartë. Sjellja antikonkurruese, siç është lidhja e marrëveshjeve të paligjshme me konkurrentët, ka pasoja shumë të rënda:

*Kërkohet nga çdo punonjës të veprojë në mënyrë të drejtë dhe në përputhje me ligjet e konkurrencës dhe të shmangë shkeljet ose t'i ndalojë ato sa më shpejt të jetë e mundur, idealisht në fillimin e tyre*



1 Messer përfshin Messer Holding GmbH dhe Messer Industries GmbH, si dhe shoqëritë e tyre të konsoliduara të grupit, dhe të gjithë CEO-t, menaxherët dhe punonjësit e kompanive të mësipërme

2 Këto rregullore zbatohen gjithashtu, me të gjitha ndryshimet që duhen bërë, për CEO-t, menaxherët dhe punonjësit në një shoqëri jo të konsoliduar të grupit, për aq sa ata janë të punësuar ose porositur për të punuar për Messer ose janë emëruar nga Messer.

3 Shi [www.unglobalcompact.org/languages/german/](http://www.unglobalcompact.org/languages/german/) ose anglisht: [unglobalcompact.org/AboutTheGC/index.html](http://unglobalcompact.org/AboutTheGC/index.html).

## 4 Tregtia Ndërkombëtare - Mbështetja e luftës kundër terrorizmit

Messer është i detyruar të respektojë dhe zbatojë të gjitha rregulloret kombëtare, shumëkombëshe dhe mbikombëtare të tregtisë së jashtme në fuqi.

Messer do të krijojë dhe mbajë një program të pajtueshmërisë tregtare.

Kjo vlen veçanërisht për sa vijon:

- Rregulloret dhe dispozitat doganore të mbështetura nga komuniteti ndërkombëtar kundër përhapjes së armëve kimike, biologjike dhe bërthamore dhe sistemeve të tyre ndihmëse
- Ndalimet e eksportit ose rieksporitit të produkteve, teknologjive dhe shërbimeve të caktuara për shtete, organizata ose individë të caktuar, me qëllim parandalimin e terrorizmit ndërkombëtar.

Prandaj, nuk i lejojmë shoqërive tona të grupit të tregtojnë ose të hyjnë në transaksione me persona që janë provuar se janë të lidhur me aktivitete terroriste ose që i përkasin ose janë të lidhur me grupe ose organizata terroriste. Të bësh biznes në vendet me embargo, ose me persona ose organizata me embargo, është subjekt i kufizimeve ose mund të jetë i paligjshëm.

Kur eksportoni mallra, duhet të sigurohet që është marrë dokumentacioni i kërkuar ose i detyrueshëm për përdorimin përfundimtar dhe/ose për përdoruesin fundor.

Gjithashtu për importimin e mallrave, Messer kërkon nga furnitorët e tij që të respektojnë kërkesat ligjore dhe të veprojnë në një mënyrë që është në përputhje me Kodin e Sjelljes së Messer. Messer pret që furnizuesit e saj të bashkëpunojnë në mënyrë aktive në arritjen e objektivave të këtij Kodi të Sjelljes.

Për sa i përket rregulloreve të tregtisë së jashtme, në parim, ligjet e të gjitha sistemeve ligjore përkatëse që zbatohen janë të detyrueshme.

***Nëse Messer dyshon ose nuk është i sigurt që një transaksion ndërkombëtar është i ligjshëm, ose nëse plotësohen të gjitha rregulloret tregtare në fuqi, atëherë do të shmanget një aktivitet i tillë.***



## 5 Siguria, Shëndeti, Mjedisi dhe Cilësia (SHEQ)

***Për të shmangur, evituar ose trajtuar në mënyrë të sigurt rrezikun e mundshëm për njerëzit dhe mjedisin, ne mbështetemi në një ndjenjë përgjegjësie dhe qëndrueshmërie.***

Për ne, kjo nënkupton mbrojtjen e mjedisit dhe ruajtjen e burimeve natyrore. Prandaj, nga zhvillimi i produktit të prodhimi, ne i përmbahemi ligjeve për mbrojtjen e mjedisit dhe rregulloreve që rregullojnë shëndetin dhe sigurinë në punë.

Për shumë nga produktet tona ekzistojnë ligje të rreptë, shpesh sepse ato përdoren në industri ose fusha që rregullohen me ligje të rreptë si kujdesi shëndetësor. Messer kërkon, zhvillon dhe punon për të mirën e njerëzve që përdorin produktet tona. Përpiqemi të sigurojmë që produktet tona janë bërë sipas standardeve më të larta në lidhje me sigurinë, shëndetin, mjedisin dhe cilësinë.

***Çdo punonjës është përgjegjës për sigurinë në zonën e tij të punës. Të gjitha rregullat e sigurisë duhet të respektohen dhe të zbatohen rreptësisht.***

Është në interesin më të mirë të çdo punonjësi dhe të gjitha kompanive të grupit, që secili punonjës të tregojë iniciativë kur bëhet fjalë për sigurinë. Secilit punonjës do t'i jepet mbështetja e nevojshme për të zhvilluar një ndërgjegjësim për risqet e mundshme të sigurisë. Nuk ka prioritet më të larta se siguria, shëndeti dhe siguria e punonjësve, klientëve dhe furnitorëve tanë.

***Kërkohet nga çdo punonjës të raportojë te mbikëqyrësi i tij rreziqet ekzistuese ose të mundshme, sapo ai të marrë dijeni për to.***



## 6 IT/Siguria e të dhënave - Mbrojtja e të dhënave - Prona e shoqërisë

Në Messer, ne përdorim sistemet e IT në mënyra të ndryshme.

***Ne marrim të gjitha masat e duhura dhe të arsyeshme për të siguruar, sa më shumë që të jetë e mundur, që konfidencialiteti i të dhënave dhe qasja në to, të mos rrezikohen nga dështimi teknik ose keqbërja ose gabimi njerëzor.***

Të dhënat personale meritojnë mbrojtje të veçantë. Messer është i përkushtuar të mbrojë të dhënat personale të punonjësve, klientëve, furnitorëve, partnerëve të saj dhe të tjerëve dhe do t'i përpunojë këto të dhëna personale vetëm në përputhje me ligjet në fuqi për mbrojtjen e të dhënave

## 7 Mbrojtja tregtare dhe e drejta e autorit

Rezultatet e kërkimit dhe zhvillimit tonë, shpikjet dhe patentat tona, dhe të gjitha pronat tona intelektuale janë asete të vlefshme dhe themeli për suksesin, vlerën, rritjen dhe avantazhin konkurrues të grupit të shoqërive tona.

Për të ndihmuar në sigurimin e besimit të vazhdueshëm të klientëve tanë, aktivitetet e marketingut, reklamimit dhe shitjes duhet të përshkruajnë ofertat dhe shërbimet tona në mënyrë të ligjshme, të drejtë dhe të ndershme. Markat tregtare të Messer duhet të përdoren në mënyrë të vazhdueshme dhe të përshtatshme për të shmangur humbjen e të drejtave ligjore.

Të gjitha reklammat dhe promovimet zyrtare duhet të miratohen nga Departamenti i Komunikimeve të Korporatës, kjo vlen veçanërisht për përdorimin e emrit ose logos së Messer nga një shoqëri e huaj.

**Informacioni konfidencial dhe sekretet tregtare të Messer janë kritike për suksesin e shoqërisë. Prandaj, informacioni konfidencial dhe sekretet tregtare të çdo lloji do t'u vihen në dispozicion vetëm personave që janë të autorizuar të kenë akses në to dhe që marrin përsipër ta trajtojnë këtë informacion në mënyrë konfidenciale.**

Gjithashtu, çdo punonjësi i kërkohet të respektojë të drejtat e pronësisë intelektuale dhe të drejtat e autorit të palëve të treta dhe të shmang përdorimin e paautorizuar të tyre, në çdo rrethanë.

## 8 Marrëdhëniet me palët e treta - Rregulloret kundër korrupsionit - Tregëtim nga persona të brendshëm

**Furnizuesit do të zgjidhen vetëm në bazë të kriterëve objektive si çmimi, cilësia, shërbimi, standardet teknike, përshtatshmëria e produktit, kohëzgjatja e marrëdhënies së biznesit, certifikimi sipas standardeve të përgjithshme (standardet ISO) ose, sipas rastit, elemente strategjike.**

Interesat personale ose marrëdhëniet personale nuk duhet të ndikojnë në asnjë mënyrë në dhënien e një kontrate.

Në lidhje me aktivitetet e biznesit, punonjësit mund të pranojnë ose ofrojnë vetëm përfitime personale, qoftë drejtpërdrejt ose në mënyrë indirekte, nëse përfshin një përfitim të zakonshëm dhe ligjor, kjo vlen veçanërisht për mbajtësit e posteve, partitë politike ose kandidatët. Duhet të shmanget në çdo rrethanë dicka që duket e pahijshme.

Messer nuk do të tolerojë ryshfet në asnjë formë. Politikat përkatëse të dhuratave dhe argëtimit janë të disponueshme për biznesin, funksionin ose rajonin e punonjësve.

Ligjet për tregëtim nga persona të brendshëm pengojnë njerëzit të tregojnë për përfitimin e tyre ose të një personi tjetër bazuar në informacione përkatëse të brendshme për të cilat ata morën dijeni përpara tregut. Messer është i përkushtuar për të mbështetur tregjet e drejta dhe të hapura të letrave me vlerë (aksione) në të gjithë botën.



## 9 Konfliktet ndërmjet shoqërisë dhe interesave private

**Çdo punonjës duhet të shmangë çdo konflikt midis interesave të tij dhe atyre të shoqërisë. Edhe në çështjet private, çdo situatë që mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë duhet të shmanget sa më shumë që të jetë e mundur.**

Investimet prej më shumë se 5% në kapitalin aksionar të një shoqërie, një klienti ose një furnitori konkurrues kërkojnë pëlqimin paraprak të drejtuesve. Investime të tilla nga drejtuesit kërkojnë miratimin paraprak të organit përgjegjës mbikëqyrës. Në masën e lejuar ligjorisht, drejtuesit ose organi përgjegjës mbikëqyrës duhet gjithashtu të informohet, pa vonesë, për çdo investim material nga të afërmit e punonjësve<sup>4</sup> në shoqëritë, klientët ose furnitorët konkurrues.

Përfundimi i një kontrate nga, ose ndonjë aktivitet tjetër biznesi ndërmjet Messer-it dhe një punonjësi, ose të afërmit ose personave juridikë të kontrolluar nga një punonjës, kërkon pëlqimin paraprak të drejtuesve ose organit përgjegjës mbikëqyrës. Në të gjitha rastet, duhet të sigurohet që punonjësi në fjalë nuk përfshihet në vendimin për dhënien e kontratës as drejtpërdrejt dhe as tërthorazi.

<sup>4</sup> Në seksionin 9, termi "të afërm" u referohet personave të mëposhtëm: (1) i fejuari ose e fejuara, (2) bashkëshorti, (3) të afërmit e shkallës së parë, përfshirë të afërmit e shkallës së parë nga martesa, (4) vëllezërit e motrat, (5) fëmijët e vëllezërve dhe motrave, (6) bashkëshortët e vëllezërve dhe motrave dhe vëllezërit e motrat e bashkëshortëve, (7) vëllezërit dhe motrat e prindërve, (8) Personat që kanë jetuar në një marrëdhënie prind-fëmijë në një familje të përbashkët për një periudhë të gjatë (fëmijë i birësuar). Personat e lartpërmendur ende konsiderohen si të afërm nëse (a) në rastin e numrave (2), (3) dhe (6) më sipër, martesa me të cilën dy persona u lidhën nuk ekziston më, (b) në rastin e numrave (3) deri në (7), marrëdhënia përfundon për shkak të një birësimi ose (c) në rastin e numrit (8), familja e përbashkët nuk ekziston më, për sa kohë që personat e përfshirë kanë ende një marrëdhënie prind-fëmijë.

## 10 Të dhëna - Dokumentacioni - Informacioni i shoqërisë

Të dhënat e sakta dhe të detajuara të shoqërisë duhet të sigurohen në kohën e duhur. As shkeljet e ligjeve të kontabilitetit, as dokumentacioni apo raportimi financiar i pasaktë nuk tolerohen nga Messer.

Deklaratat zyrtare, veçanërisht për shtypin ose mediat e tjera, mund të jepen vetëm nga punonjës të autorizuar.

Duhet treguar kujdes i veçantë kur kemi të bëjmë me qeverinë si klient ose kur kemi të bëjmë me një rregullator qeveritar. Çdo informacion i dhënë për një qeveri, qoftë si klient apo si rregullator duhet të jetë e vërtetë dhe e saktë duke mbrojtur në mënyrë efektive interesat legjitime të Messer.

Të gjithë punonjësit përkatës të Messer duhet të ndihmojnë për të siguruar që raportimi i informacionit të biznesit – i kompjuterizuar, në letër ose në çdo format tjetër – të jetë i saktë, i sinqertë dhe në kohë.



## 11 Shkeljet e pajtueshmërisë

Rregullat e përfshira në këtë Kod të Sjelljes kërkojnë një rishikim objektiv dhe përshtatje të sjelljes së dikujt, brenda kuadrit të standardeve të përshkruara më sipër.

Në disa raste, punonjësit ende ndihen të pasigurt se çfarë të bëjnë pavarësisht udhëzimeve në Kodin e Sjelljes Messer. Testi i mëposhtëm i Integritetit përcakton elementet që të tjerët i kanë gjetur të dobishme kur përballen me një vendim të vështirë. Në asnjë mënyrë nuk synohet të jetë përfundimtar.

Çdo punonjës duhet të pyesë veten nëse sjellja e tij

- është e ligjshme dhe në përputhje me vlerat dhe rregulloret e Messer.
- është në interesin më të mirë të Messer dhe nuk ndikohet nga interesat konfliktuale të dikujt.
- ndikohet nga bindja personale se ka marrë vendimin e duhur dhe ka ndjekur busullën e tij etike.
- mund të përfaqësohet para eprorëve, kolegëve dhe familjes ose miqve të tij me një ndërgjegje të pastër.
- do të përballej me shqyrtimin e palëve të treta.
- ruan reputacionin e mirë të Messer.

Nëse ka ndonjë dyshim për një nga këto pyetje në një rast specifik, pika e parë e kontaktit është zakonisht eprori i drejtpërdrejtë i dikujt, i cili do të përpiqet të vlerësojë situatën dhe të zgjidhë problemin. Për këshilla të kualifikuara, mund t'i drejtoheni edhe menaxherit përgjegjës të pajtueshmërisë.

Në lidhje me çështjet dhe shqetësimet e punonjësve, të gjithë menaxherët dhe përgjegjësit e pajtueshmërisë në Messer pritet të kenë një politikë "me dyer të hapura" pra të mirëpresin këdo ka një shqetësim për të shprehur, një angazhim të madh dhe një nivel të lartë zelli për të zgjidhur çdo problem që duhet të adresohet.

*Shkeljet e mundshme të pajtueshmërisë mund t'i raportohen vetëm personit përgjegjës në përputhje me procedurën e përcaktuar të raportimit.*


Informacioni i detajuar mund të gjendet në intranet (<https://messernet/en/web/compliance/home>) dhe faqen tonë (<https://corporate.messergroup.com/en/compliance-management-system>) në Udhëzimin mbi raportimin dhe trajtimin e shkeljeve të rregullave në Messer.

Për shkelje të vogla të pajtueshmërisë, **punonjësit dhe Partnerët e Biznesit** duhet të raportojnë kryesisht tek Përgjegjësi Vendor për Pajtueshmërinë ose Përgjegjësi për Pajtueshmëri në Fushën përkatëse ose një personi kontakti të drejtpërdrejt në Messer, i cili është përgjegjës për temën dhe vendndodhjen. Megjithatë, ato mund të raportohen edhe nëpërmjet Linjës së Integritetit ose nëpërmjet email ([compliance@messergroup.com](mailto:compliance@messergroup.com))

Shkeljet e rënda të pajtueshmërisë duhet të raportohen kryesisht nëpërmjet Linjës së Integritetit ose drejtpërdrejt tek Përgjegjësi i Lartë për Pajtueshmërinë.

*Linja e Integritetit, e cila menaxhohet nga një ofrues i jashtëm në emër të Messer, është e disponueshme:*

bazuar në ueb në: [www.messer.ethicspoint.com](http://www.messer.ethicspoint.com) ose me telefon (Numri i telefonit për vendin tuaj mund të gjendet në faqen e internetit)



Bad Soden, Nëntor 2023  
Messer SE & Co. KGaA



Bernd Eulitz  
CEO



Helmut Kaschenz  
CFO



Dr. Werner Hickel  
COO për Azinë



Virginia Esly  
COO për Europën



Elena Skvortsova  
COO për Amerikën



Version 11/2023



**Messer SE & Co. KGaA**  
Messer-Platz 1  
65812 Bad Soden  
[www.messergroup.com](http://www.messergroup.com)